



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.03.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:
Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Me propozim të deputetit Ben Blushi dhe kërkesë të Komisionit për Politikën e Jashtme, Zj. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes, informon deputetët në lidhje me qëndrimin e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s për situatën në Ukrainë.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Namik Dokle, Ben Blushi, Valentina Leskaj, Olta Xhaçka, Përparim Spahiu, Kastriot Islami, Gert Bogdani, Vangjel Dule,.

Mungojnë:

Gramoz Ruci, Jozefina Topalli, Eduard Selami, Shpëtim Idrizi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Z. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes;
Z. Jeronim Bazo, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura
Z. Gjergj Teneqexhi, Drejtor Kabineti, Ministria e Mbrojtjes
Z. Igli Hasani, Ministria e Mbrojtjes

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade – Përshëndetje! Mirëmëngjes! Kemi sot një seancë të veçantë të Komisionit për Politikën e Jashtme. Me praninë e Zonjës Mimi Kodheli, Ministre, me grupin që e shoqëron, Zotin Bazo, Shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe Zotin Teneqexhi, Drejtor i Kabinetit.

Dua ta falenderoj zonjën Ministre për përgjigjen në një kohë shumë të shkurtër për të qenë e pranishme në Komisionin për Politikën e Jashtme për t'ju përgjigjur interesimit të deputetëve në lidhje me situatën delikate në Ukrainë. Është një situatë që ka tërhequr vëmendjen të gjithë organizmave euro-atlantike ku Shqipëria bën pjesë, por dhe ato globale, që nga Kombet e Bashkuara, NATO, OSBE, Këshilli i Evropës, përfshirë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër edhe Shqipëria ka qëndrimet e veta të unifikuara si shtet dhe anëtar i NATO-s dhe kjo është arsyeja kryesore që Ministrja e Mbrojtjes, Zonja Kodheli është e pranishme këtu me kërkesën e deputetëve të nderuar, me propozim të Zotit Blushi dhe mbështetjen e anëtarëve të tjerë të Komisionit.

Ju të nderuar deputetë e dini që në Shqipëri të gjithë faktorët politikë janë të unifikuar në qëndrimet e tyre në lidhje me situatën në Ukrainë dhe sigurisht hap pas hapi Ministria e Jashtme ndjek situatën dhe transmeton mesazhe në përputhje me të gjithë angazhimet që vendi ynë ka si vend anëtar i NATO-s dhe anëtar i organizmave të tjerë euro-atlantikë. Ju falenderoj dhe një herë, Zonja Ministre për praninë, dhe dëshiroj t'ju jap fjalën për të bërë një prezantim të shkurtër në lidhje me qëndrimin e shtetit shqiptar rreth situatës në Ukrainë.

Mimi Kodheli – Ju faleminderit zonja Kryetare. Falenderoj dhe kolegët për interesimin dhe kam nderin të jem në një komision të nderuar por edhe në mes kolegësh. Në fakt është realisht kënaqësi të ndajmë bashkarisht atë që Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka bërë në një periudhë kaq intensive në aspektin gjeo-politik që është periudha të cilën e kemi perceptuar të gjithë si një periudhë me problematikë të spikatur ndaj dhe qeveria e ka në vëmendje këto zhvillime të fundit, sidomos zhvillimet në Ukrainë që në momentet e para të shpërthimit të krizës një periudhë e cila në fakt korrespondon edhe me muajt e parë të punës së këtij fillim-viti.

Në fakt Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, e ka dënuar ndërhyrjen me forca ushtarake të Federatës Rusë në Ukrainë, ndërhyrje kjo në kundërshtim të hapur me normat e së drejtës ndërkombëtare dhe në shkelje të sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit.

Ne kemi shprehur mbështetjen dhe jemi të vendosur pro sovranitetit dhe integritetit territorial dhe unitetit të Ukrainës, si dhe mbështesim të drejtën e popullit ukrainas për të përcaktuar të ardhmen e tij pa ndërhyrje nga jashtë.

Më duhet t'ju them se, me lejen tuaj zonja Kryetare dhe me lejen e komisionit të nderuar, kjo ishte e vetmja gjë që mund të ndanim në praninë e mediave. Besoj që për çdo informacion tjetër që më duhet të ndaj me ju, për shkak të sensibilitetit të informacionit dhe konfidencialitetit që duhet të mbaj në një moment si ky, falenderoj mediat dhe me lejen tuaj të vazhdojmë mbledhjen pa praninë e tyre.

Arta Dade – Faleminderit Zonja Ministre! Media është e lutur të largohet

(Mledhja e Komisionit për Politikën e Jashtme vazhdon me dyer të mbyllura)